



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 354/1 Prot.

Tiranë, më 06 / 03 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 37, Datë 06 / 03 / 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 153, datë 21.09.2018, të bërë nga A.P, kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike”, “moshës<sup>1</sup>” dhe “gjëndjes shëndetësore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se: *“Ka qenë i punësuar pranë Qendrës së Shërbimit dhe Gjeofizikës Patos (Q.SH.GJ Patos) në pozicionin si Kryeinxhinier. Me Vendimin nr.246, datë 17.04.2018 i është komunikuar lirimi nga detyra e Kryeinxhinierit dhe emërimi si Inxhinier në dispozicion të Q.Sh.Gj Patos, detyrë të cilën e ka refuzuar pasi nuk ka patur një motivacion për shkarkimin e tij. Një javë pas shkarkimit të tij është emëruar një person tjetër në detyrën e Kryeinxhinierit. Me Vendimin 304, datë 14.05.2018 i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës për arsye se nuk është paraqitur në vendin e punës nga data 18.04.2018”*. Ankuesi deklaroi se është larguar nga detyra për shkak të bindjes politike në një moment që ka qenë në gjendje të rënduar shëndetësore. A.P shprehet se në moshën që ka, është e pamundur që të fillojë punë në një kompani tjetër.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale në lidhje me shkaqet e pretenduara dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 24.09.2018, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime lidhur me shkaqet e pretenduara dhe lidhjes shkakësore të trajtimit të pabarabartë me punonjësit e tjerë të Albpetrol sh.a.

---

<sup>1</sup> A.P ka lindur në datë 26.05.1956.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkaqet e pretenduara, pasi i është shkaktuar një gjendje e rënduar shëndetësore dhe pamundësi punësimi deri në daljen në pension.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr.153, datë 21.09.2018 të A.P u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1310/1, datë 27.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Albpetrol sh.a për ankesën e bërë nga A.P si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Kopje të procedurës së emërimit dhe largimit nga detyra e Kryeinxhinierit për punonjësin A.P.

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Përshkrimin e punës dhe kualifikimet për pozicionin e punës Kryeinxhinier në Q.SH.GJ. Patos.
  - Kopje të kontratës, librezës, vlerësimit të punës, arsimit dhe kualifikimit të A.P.
  - Informacion nëse në vend të A.P është emëruar një punonjës tjetër. Nëse po, një kopje e dosjes personale si dhe kopje të procedurës së ndjekur për emërimin e tij.
  - Kopje të Vendimit nr.67, datë 29.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sha.
  - Informacion nëse dhe nga Qëndrat e tjera të Shoqërisë Albpetrol janë bërë largime nga pozicioni i Kryeinxhinierit nga data 01.01.2018 deri me datë 17.04.2018 (nëse po, kopje te procedurës).
- Me shkresën kujtesë, nr. 1601, datë 13.11.2018 i është kërkuar përsëri informacioni i datës 27.09.2018, subjektit Albpetrol sh.a
  - Me shkresën nr. 9319/1, datë 15.11.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albpetrol sh.a në mes të tjerash informoi se: *“A.P ka qenë punonjës i shoqërisë Albpetrol sh.a nga data 16.08.1980 deri më 14.05.2018 dhe ka mbajtur pozicione të ndryshme pune. Së fundmi, A.P ka mbajtur pozicionin e punës, Kryeinxhinier pranë Q.Sh.Gj Patos nga data 09.03.2016 deri në datën 17.04.2018. Me Vendimin nr.246, datë 17.04.2018 ankuesi është liruar nga detyra e kryeinxhinierit pranë Q.Sh.Gj Patos dhe është caktuar në detyrën inxhinier në dispozicion të Q.Sh.Gj Patos deri në një vendim të dytë. Pas lirimit nga detyra dhe caktimit në detyrën e re me shkresën nr.216/1, datë 17.04.2018 me lëndë “Mbi marrëdhëniet e punës” ankuesi ka njoftuar shoqërinë Albpetrol sh.a se nuk e pranon detyrën e re dhe për këtë arsye nuk është paraqitur në vendin e punës nga data 17.04.2018 dhe në vazhdim. Të ndodhur në këto kushte, ku punëmarrësi nuk dëshiron të ofronte shërbimin e tij të punës kundrejt punëdhënësit, është kryer zgjidhja e marrëdhënieve të punës me A.P për shkak të mosparaqitjes në vendin e punës”.*

Në pozicionin e punës K/inxhinier në Qendrën e Shërbimeve Gjeofizike Patos, është emëruar Dh.Gj me profesion inxhinier i vendburimeve të naftës dhe gazit, datëlindja 03.05.1955, me vjetërsi pune në naftë 34 vite e 7 muaj.

Për sa i përket arsyes së transferimit dhe uljes në detyrë të A.P, Albpetrol sh.a informon se lëvizja është kryer në kuadër të ristrukturimit të Albpetrol sh.a dhe për këtë qëllim janë ndërmarrë disa veprime për riorganizimin e brendshëm të qendrave në varësi duke kryer ndryshime të cilat janë menduar si të nevojshme për mbarëvajtjen e punëve si dhe referuar kompetencave që Administratorit i njeh Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 158, Rregullorja e Brendshme e funksionimit të vetë shoqërisë si dhe Statutin e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Për sa i përket pretendimit për diskriminim për shkak të moshës nuk qëndron, pasi A.P është zëvendësuar nga një punonjës me moshë më të madhe dhe ky fakt tregon qartë që nga ana e Albpetrol sh.a, mosha nuk është preferencë për këtë vend pune.

Për sa i përket pretendimit për diskriminim për shkak të bindjes politike, Albpetrol sh.a informon se nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj. Nga verifikimet e kryera në dosjen personale të A.P, nuk rezulton asnjë e dhënë mbi përkatësinë politike të tij.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore, Albpetrol sh.a informon se pretendimi është tërësisht i pabazuar dhe mungon lidhja shkakësore mes pretendimit dhe procedurës së largimit nga puna të ankuesit. Lëvizja në detyrë është kryer për një shkak të ligjshëm siç është procesi i ristrukturimit, dhe nga verifikimet e kryera rezulton se nga ana e ankuesit nuk është paraqitur asnjë raport mjekësor apo dokument që të vërtetonte gjëndje të rënduar shëndetësore.

Lëvizja në detyrë e ankuesit është kryer në kuadër të riorganizimit të brendshëm të Q.Sh.Gj Patos, si rrjedhojë e të cilit u liruan nga detyra dy drejtuesit kryesor të kësaj qendre, Drejtori I.G si dhe ankuesi A.P në cilësinë e Kryeinxhinierit. Përveç Q.Sh.Gj Patos, janë kryer ndryshime dhe lëvizje të punonjësve (me pozicion pune Drejtor/Kryeinxhinier, etj) dhe në qendra të tjera në varësi të Albpetrol sh.a. Konkretisht, janë kryer lëvizje si më poshtë:

- Më datë 14.02.2018 është liruar nga detyra Drejtori i Q.P.N Ballsh E.A dhe ka kaluar në dispozicion të kësaj qendre deri në një vendim të dytë.
- Më datë 23.02.2018 është liruar nga detyra Drejtori i Q.T Patos P.I dhe ka kaluar në dispozicion të kësaj qendre deri në një vendim të dytë.
- Më datë 17.04.2018 është liruar nga detyra Kryeinxhinieri pranë Q.A.Sh.N.G Patos Rr.C dhe është transferuar Kryeinxhinier pranë Q.P.N Fier.

Në përfundim, qëndrimi i Albpetrol sh.a bazuar në të gjithë praktikën shkresore e cila përbën provë ligjore, është që A.P nuk i është zgjidhur marrëdhënia e punës, pra nuk është lënë i papunë, por është ngarkuar me një detyrë të re e cila në vlerësimin tonë është lëvizje paralele, në përputhje të plotë me përgatitjen dhe kualifikimin e tij personal si inxhinier. Ka qenë vetë A.P që nuk e ka pranuar këtë detyrë të re dhe ka deklaruar që nuk e pranon detyrën e re me shkresën nr.3467, datë 18.04.2018. Në shkresën e hartuar nga Albpetrol sh.a për ndryshimin e pozicionit të punës nuk ka të shprehur asnjë element diskriminues.

- Në përgjigje të shkresës së Albpetrol sh.a, dhe shpjegimeve të kërkuara nga Komisioneri, ankuesi A.P, me e-mail-in datë 21.11.2018 në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Lirimi i tij nga detyra si Kryeinxhinier pranë Q.Sh.Gj Patos nga Administratori K.B është bërë menjëherë pas emërimit të ri nga politika të A.Ç. Z.A. me arsim mësues, i zgjedhur në katër legjislatura Kryetar i Rajonit nr.3 Fier, ka filluar punë në shoqërinë Albpetrol sh.a në vitin 2016 me detyrë drejtor dhe përsëri në muajin Prill 2018 emërohet drejtor në Q.Sh.G Patos. Dh.Gj rikthehet nga politika në vitin 2013 në shoqërinë Albpetrol për 5 vite në pozicionin vetëm drejtor dhe emërohet në muajin Gusht 2018 Kryeinxhinier në Q.Sh.Gj Patos. K.N rikthehet nga politika në vitin 2013 dhe emërohet Kryeinxhinier në Q.Sh.Gj Patos, shkarkohet në muajin Shkurt 2016 nga Administratori E.P. Në muajin Maj komandohet Kryeinxhinier në Q.Sh.Gj pasi ky pozicion u refuzua nga I.G. J.Gj me arsim oficer në vitin 2014 nga politika emërohet drejtues teknik në*

*sektorin Q.A.R Patos, ushtarak në lirim, me status kryetar seksioni të Partisë Socialiste, lagjja "15 Tetori" Fier (duke e zëvendësuar në këtë pozicion) i cili nuk ka njohuritë përkatëse teknike për menaxhimin e asetëve në pronësi të Albpetrol sh.a, etj".*

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të moshës, A.P informon se: "I.G është emëruar K/inxhinier në Q.Sh.Gj Patos me datë 17.04.2018 (zëvendëson A.P) me eksperiencë në shoqërinë Albpetrol prej 10 vitesh me moshë 50 vjeç. K.N komandohet në muajin Maj 2018, Kryeinxhinier në Q.Sh.Gj Patos në moshën e daljes në pension për 15 ditë (30.05.2018) mbush moshën e pensionit. Me vendim të administratorit, K.N vazhdon të punonjë në Q.Sh.Gj Patos. Dh.Gj në muajin Gusht emërohet Kryeinxhinier në Q.Sh.Gj Patos me vjetësi pune më pak se E.P dhe për 8 muaj del në pension. Sqarohet se E.A dhe P.I kanë filluar punë në Albpetrol në vitin 2013 deri në vitin 2018 si drejtorë dhe ristrukturimi i Albpetrol ka shkurtuar pozicionet e drejtorëve në ndërrmarrjet ku ata ishin emëruar. Në Q.Sh.Gj Patos ristrukturimi nuk ka ndryshuar strukturën organizative të administratës".

A.P informon se vuan nga Hipertonia kronike dhe pilonefrit kronik në veshkë për të cilat mjekohet rregullisht, si dhe gjatë vitit 2018 trajtohet me mjekime për artrinin në gjymtyrë e shoqëruar me dhimbje dhe vështirësi në ecje.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga ankuesi, rezulton se pretendimet që rrjedhin nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, subjekti ankues i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me Vendimin nr. 62-2018-4898, datë 03.10.2018 ka vendosur konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënieve të punës duke detyruar palën e paditur, Albpetrol sh.a t'i paguajë paditësit A.P dëmshpërblim. Vendimi nuk ka marrë formë të prerë.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 153, datë 21.09.2018, Komisioneri me shkresën nr. 1310/3, datë 05.12.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 13.12.2018.

Në seancë dëgjimore si përfaqësues të palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa, ishin prezent: Y.S dhe E.Ç përfaqësues të Shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe subjekti ankues, A.P.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Subjekti ankues parashtroi dhe një herë pretendimet e tij, në të cilin theksoi faktin se gjatë marrëdhënieve të punësimit në Albpetrol nuk ka patur masë disiplinore apo vërejtje në drejtim të marrëdhënieve të punës. Ankuesi bëri të ditur se në datë 17.04.2018 është transferuar nga detyra e K/inxhinierit pa i caktuar vend pune dhe pa i saktësuar pagesën, ndërsa theksoi se pas largimit

të tij nga puna gjendja e tij shëndetësore është përkeqësuar. Lidhur me ngjarjet e vjedhjeve të konstatuara në QSHGJ Patos, A.P shpjegoi se në pozicionin e K/inxhinierit nuk ka marrë pjesë në caktimin e detyrave të rojeve dhe se përgjegjësia organizative për ngjarjet ka qenë e drejtorit dhe shefit të burimeve njerëzore.

Nga ana e përfaqësuesve së Shoqërisë Albpetrol sh.a, u theksua fakti se ulja në detyrë e A.P u bë nga ana e drejtuesve të Albpetrol për arsye të një organizimi më të mirë të punës pas ngjarjeve të ndodhura në QSHGJ Patos ku u konstatuan mungesa të materialeve në magazinë, dhe për këtë u mendua që të bëhej organizim i ri i drejtimit të QSHGJ Patos. Përfaqësuesit e Albpetrol sqaruan se, në Shoqërinë Albpetrol për përmirësimin e punës ka pasur dhe lëvizje të drejtuesve në disa qendra të tjera dhe këto lëvizje nuk janë bërë vetëm në QSHGJ Patos.

Në lidhje me pretendimin për gjendjen shëndetësore të A.P, përfaqësuesit e Albpetrol u shprehën se nuk ishin në dijeni të gjendjes shëndetësore të A.P pasi në dosjen e tij nuk figuron asnjë epikrizë, raport shëndetësor apo mungesa në punë për arsye shëndetësore në mënyrë që Albpetrol të ishte në dijeni të gjendjes shëndetësore të A.P.

Në lidhje me pretendimin për bindjen politike të A.P, përfaqësuesit e Albpetrol u shprehën se nuk ishin në dijeni, por theksuan faktin se gjatë periudhës 2013 e në vijim A.P ka patur vlerësime pozitive dhe është caktuar vazhdimisht në pozicione drejtuese. U la si detyrë që në vijim nga Albpetrol sh.a të silleshin dokumentacion mbi analizën e ngjarjes të ndodhur në QSHGJ Patos dhe masat organizative dhe disiplinore të marra për këto ngjarje.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, Komisioneri me shkresën nr.111, datë 22.01.2019 i është drejtuar Shoqërisë Albpetrol sh.a lidhur me kërkesën për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 13.12.2018.

Me shkresën nr. 934, datë 31.01.2019, Shoqëria Albpetrol sh.a ka dërguar pranë Komisionerit, kopje të analizës të mbledhjes mbi ngjarjen e ndodhur në magazinën qendrore në Sektorin e Uzinës Mekanike pranë QSHGJ Patos të datë 05.04.2018 dhe rezultatet ekonomiko-financiare të vitit 2017 të QSHGJ Patos.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Referuar librezës së punës së A.P rezulton se, ankuesi ka filluar punë në Degën NRFISH Fier në detyrën si Inxhinier në datë 01.06.1981, dhe ka vazhduar marrëdhëniet e punës në detyra të ndryshme deri në datë 14.05.2018. Referuar Regjistrin Themeltar të QSHGJ Patos rezulton se A.P pas vitit 2013 ka pasur këto pozicione pune: - Drejtues Teknik nga data 01.05.2013 deri më 31.03.2014 në QKAR Patos. – Përgjegjës i Degës Teknike nga data 31.03.2014 deri më

02.12.2015 në QASHNG Patos. – Kryetar i Degës Teknike nga data 02.12.2015 deri më 08.03.2016 në QPN Patos.

Me Vendimin nr. 93, datë 08.03.2016 të Albpetrol sha, A.P është liruar nga detyra e Kryetarit të Degës Teknike pranë QPN Patos dhe është transferuar në pozicionin e punës K/inxhinier pranë QSHGJ Patos. Me Vendimin nr.246, datë 17.04.2018 të Albpetrol sh.a, ankuesi është liruar nga detyra e K/inxhinierit pranë Q.Sh.Gj Patos dhe është caktuar në detyrën Inxhinier në dispozicion të Q.Sh.Gj Patos deri në një vendim të dytë. Pas lirimit nga detyra dhe caktimit në detyrën e re me shkresën nr.216, datë 17.04.2018 me lëndë “Refuzim Vendimi nr.246, datë 17.04.2018 të Albpetrol sha” A.P ka njoftuar shoqërinë Albpetrol sh.a se nuk e pranon detyrën e re pasi nuk ka një motivacion për shkarkimin e tij dhe e konsideron ndërprerjen e kontratës në pozicionin e K/inxhinierit, të paarsyetuar, të njëanshme dhe të menjëhershëm. Me Vendimin nr. 304, datë 14.05.2018 të Albpetrol sha, A.P i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës për arsye se nuk është paraqitur në vendin e punës nga data 17.04.2018 dhe në vazhdim.

Pretendimi i subjektit ankues për diskriminim i ka fillesat në momentin e kalimit të A.P nga pozicioni i K/inxhinierit të QSHGJ Patos, në pozicionin Inxhinier në dispozicion. Referuar Vendimit nr.246, datë 17.04.2018 të Administratorit të Albpetrol sh.a, shkruhet se emërimi i A.P bëhet në vijim të procedurave mbi ristrukturimin e Shoqërisë Albpetrol sh.a. Bazuar në këtë vendim punonjësi A.P është kaluar nga detyra e K/inxhinierit në detyrën Inxhinier në dispozicion.

Lidhur me çështjen e sipërpërmendur, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a ka barrën e provës<sup>3</sup> të provojë që lëvizja e ankuesit në pozicionin e inxhinierit në dispozicion është kryer për arsye të ligjshme dhe të justifikuara dhe jo për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Në analizë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët lidhur me ndryshimin e pozicionit të punës të ankuesit për një organizim të ri të punës pas ngjarjeve të ndodhura në magazinën e QSHGJ Patos vërehet se, në analizën e ngjarjes së ndodhur në datë 05.04.2018, A.P nuk rezulton me asnjë lloj përgjegjësie si organizative po ashtu dhe ligjore lidhur me ngjarjen, në mënyrë që Albpetrol sh.a të justifikonte lëvizjen nga detyra të A.P pa miratimin e tij.

Në dokumentacionin e dorëzuar nga Albpetrol sha, rezulton se, me shkresën nr. 191/1, datë 05.04.2018, Drejtori i QSHGJ Patos pas përfundimit të analizës në sektorin ku kishte ndodhur ngjarja, i ka propozuar Administratorit të Albpetrol sh.a, pezullimin nga detyra të 8 punonjësve të Sektorit Uzina Mekanike Patos deri në zbardhjen e ngjarjes nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Me Urdhrin nr. 31, datë 02.05.2018 Administratori i Albpetrol sh.a ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” me motivacionin “Dëmtimi i pronës, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, krijimi pa shkaqe të pranueshme i mundësisë për

---

<sup>3</sup>Kodi i Punës në neni 9 “Ndalimi i diskriminimit, pikat 9 dhe 10 e tij parashikojnë se: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.  
10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

dëmtim apo keqpërdorim të pronës së shoqërisë” për 8 punonjës në detyrat, magazinier (1) dhe roje (7).

Në dokumentacionin e dorëzuar nga Albpetrol nuk rezultojnë asnjë dokument në të cilin të provohet përgjegjësia funksionale apo organizative e A.P në këtë ngjarje, në mënyrë që të justifikohet dhe lëvizja e tij në një detyrë më të ulët në përgjegjësi. Si rezultat i lëvizjes në detyrë, A.P i janë ndryshuar kushtet e kontratës në disfavor pa e diskutuar më parë dhe pa pëlqimin e tij. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se Administratori i Albpetrol sh.a në zbatim të kompetencave të tij, në rast të konstatimit të përgjegjësisë ligjore në drejtim të K/inxhinierit ka patur mundësinë për dhënie të masës disiplinore ndaj A.P, por jo për të kryer ndryshim në pozicionin e punës, sidomos kur kjo ulje rezultojnë me ulje në detyrë dhe pagë më të ulët.

Paligjshmëria e veprimit të Albpetrol duke i ndryshuar kushtet e punës punëmarrësit A.P është konstatuar dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e cila me Vendimin nr. 62-2018-4898, datë 03.10.2018 ka vendosur konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënieve të punës duke detyruar palën e paditur, Albpetrol sh.a t’i paguajë paditësit A.P dëmshpërblim në masën e 35 pagave mujore, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datë 13.12.2018, dhe në dokumentacionin e dorëzuar me shkresën nr. 9319/1, datë 15.11.2018, Albpetrol sh.a informoi se ka patur dhe drejtues<sup>4</sup> të tjerë të qendrave të Albpetrolit që janë lëvizur në detyrë në kuadër të riorganizimit të brendshëm të Albpetrol sh.a. Në lidhje me këtë, Komisioneri vlerëson se informacioni i dhënë nga Albpetrol nuk mund të shërbejë si krahasues për rastin në fjalë pasi personat nuk janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin. Sipas Albpetrol sh.a, E.A, me Urdhrin nr. 92, datë 14.02.2018 është liruar nga detyra e Drejtorit të Q.P.N Ballsh dhe ka kaluar Inxhinier në dispozicion të kësaj qendre për mosrealizim të treguesve të përcaktuar në programin e zhvillimit të shoqërisë bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria e Prodhimit.

Në analizë të procesit të ristrukturimit organizativ të Albpetrol sh.a dhe referuar strukturës së vjetër dhe të re administrative të QSHGJ Patos, vërehet se struktura e re organizative e QSHGJ Patos është dërguar për zbatim me shkresën 5533/5, datë 02.07.2018, që do të thotë rreth tri muaj pas lirimt të A.P, dhe për më tepër që në nivel drejtues (drejtor, k/inxhinier) nuk ishte parashikuar ndryshim.

Në lidhje me procedurën e zëvendësimit të A.P, Albpetrol sh.a ka vënë në dispozicion të Komisionerit vetëm Vendimin nr.422, datë 09.07.2018 të emërimit të Dh.Gj në pozicionin e K/inxhinierit por nuk janë vënë në dispozicion, shkresat e emërimeve të dy punonjësve të tjerë të emëruar më përpara, I.G dhe K.N në pozicionin e K/inxhinierit, fakte këto të deklaruara nga A.P gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

Në analizë të situatës së ankuesit lidhur me transferimin e tij nga pozicioni i K/inxhinierit në atë të Inxhinierit në dispozicion, Komisioneri vlerëson se, justifikimi i Shoqërisë se ky transferim ka ndodhur në kuadër të riorganizimit të QSHGJ Patos, për shkak të ngjarjeve të ndodhura, nuk

---

<sup>4</sup> E.A, P.I dhe Rr.C.



është objektivisht i justifikuar për arsye se ankuesit, në përfundim të analizës së ngjarjes, nuk i është ngarkuar asnjë lloj përgjegjësie në drejtim të marrëdhënieve të punës.

Nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se lirimi i ankuesit nga pozicioni i K/inxhinierit në atë të Inxhinierit në dispozicion, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a duke e ulur në detyrë dhe duke i ndryshuar kushtet e punës dhe të ardhurat.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën e subjektit ankues pretendohet diskriminim, për shkak shkak të “bindjeve politike”, “gjendjes shëndetësore” dhe “moshës”, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

“Bindja politike”, “mosha” dhe “gjendja shëndetësore” janë disa prej shkaqeve, për të cilat, Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “bindjes politike”, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk ka depozituar asnjë fakt për të vërtetuar bindjen e tij politike. Në këto kushte nuk mund të pretendojë për diskriminim për këtë shkak.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk ka depozituar asnjë fakt që të vërtetojë se Albpetrol sh.a ka qënë në dijeni të gjendjes shëndetësore të A.P përpara datës 17.04.2018, përkundrazi gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore ankuesi deklaroi se gjendja e tij shëndetësore është përkeqësuar pas largimit të tij nga puna. Në këto kushte nuk mund të pretendojë për diskriminim për këtë shkak.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “moshës”, Komisioneri vlerëson se “mosha” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Bazuar në provat shkresore, subjekti ankues mbart shkakun e moshës pasi i duhen dhe tri vite për të dalë në pension dhe ka rreth 36 vite eksperiencë punë pranë Albpetrol sh.a.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>5</sup>, për të cilat ankuesi pretendon diskriminim dhe trajtimit të padrejtë të tij.

Sa më sipër, duke patur parasysh që ankuesi nuk arriti të provojë që mbart shkaqet e “*bindjes politike*” dhe “*gjendjes shëndetësore*”, KMD u fokusua tek pretendimi për diskriminim për shkak të moshës.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Albpetrol sh.a në datë 17.04.2018 ka emëruar në detyrën e K/inxhinierit të QSHGJ Patos I. G., i cili nuk e ka pranuar detyrën e K/inxhinierit<sup>6</sup>.
- Albpetrol sh.a me vendimin nr.304, datë 14.05.2018 ka njoftuar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me A.P, dhe më pas në datë 17.05.2018, ka emëruar në detyrën e K/inxhinierit K.N, i cili për 15 ditë mbushte moshën e pensionit.
- Albpetrol sh.a me Vendimin nr.422, datë 09.07.2018 ka emëruar Dh.Gj në pozicionin e K/inxhinierit pranë QSHGJ Patos të cilit i duhen dhe 8 muaj për të dalë në pension.

Referuar sa më sipër, nuk provohet se largimi nga puna i ankuesit ka ardhur për shkak të moshës së tij. Kjo për faktin se dy nga tri punonjësit që janë emëruar në pozicionin e K/inxhinierit janë më të moshuar se ankuesi.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “*Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”.

<sup>5</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>6</sup> Referuar deklaratimit të subjektit ankues “z. Ildir Gëro me moshë 50 vjeç, nuk e ka pranuar detyrën”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e Albpetrol sh.a, por nuk u gjenden prova dhe fakte të vertetojnë lidhjen objektive ndërmjet këtij trajtimi dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të për shkak të moshës.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit A.P nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a për shkak të moshës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**